REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/ KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDYIE
02 Nr./Br./No. 1049
Data/Datum/Tarih 20-07-2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

## ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (LVL) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

## VENDIM

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **1000 (njëmijë euro)** për Mirjeta Sylejmani për trajtimin e sëmundjes së fëmijës si dhe për nevoja ushqimore për fëmijët për shkak të kushteve të rënda ekonomike. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor – Zyra e Kryetarit të Komunës.

2. Mjetet derdhen në xhirollogarinë e Mirjeta Sylejmani [redacted]

3. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim e përfituesit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

**Vendimi i dorëzohet**

- Palëve,
- DBF, dhe
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/KOSOVA CUMHURIYETI
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
02 Nr/Br/No 1048
Data/Datum/Tarih 20-07-2023
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE**
**MUNICIPALITY OF GJILAN**
**GILAN BELEDIYESI**

---

**MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM**

**ndërmjet**

**Komunës së Gjilanit, si autoritet publik**

**dhe**

**Mirjeta Sylejmani, përfitues**

**Gjilan, 2023**

**Neni 1**
**Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për Mirjeta Sylejmani nga Gjilani, për mbulimin e shpenzimeve për trajtimin e sëmundjes fëmijët si dhe për nevoja ushqimore, sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren **01. nr. 016-126422 dt. 29.12.2016** e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren **nr. 2/208,01 nr. 016-28468 dt. 22.03.2018** për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 22 paragrafi 1.8)

**Neni 2**
**Vlera e Subvencionimit**

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej **1000 €** (njëmijë euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor – Zyra e Kryetarit të Komunës.

2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilanit për përfituesin.

**Neni 3**
**Obligimet e palëve**

1. **Obligimet e përfituesve të subvencionit janë:**

   **1.1.** mjetet e marra, përfituesit do t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllimet e paraqitura në Kërkesë.
   **1.2.** përfituesit duhet të raportojnë tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.

2. Përfituesit duhet të sjellin tek Komuna e Gjilanit:

   **2.1.** raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje).

   **2.2.** njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit.

**Neni 4**

1. **Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:**

   **1.1.** obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
   **1.2.** bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.

2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

**Neni 5**
**Afatet kohore**

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.

2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

**Neni 6**
**Shkëputja e marrëveshjes**

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

   **1.1.** tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
   **1.2.** marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
   **1.3.** shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
   **1.4.** mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

**Neni 7**
**Kthimi i mjeteve**

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesit janë të obliguar t'i kthejnë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

**Neni 8**
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

**Neni 9**
**Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

**Neni 10**
Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.

**Komuna e Gjilanit**
____________________
**Kryetari i Komunës**
**Alban Hyseni**

M.S
____________________
**Mirjeta Sylejmani**